

Pyetje dhe Përgjigje

Si mund te pajisem me produktin e-banking?

Ju mund të pajiseni me produktin tonë e-banking duke u paraqitur në një nga deget tona me te afërta te Procredit Bank.

Çfarë shërbimesh mund të kryhen me shërbimin e-banking?

Me produktin e-banking mund të bëhen:

- Monitorim i llogarisë 24/7
- Transferta kombëtare
- Transferta ndërkombëtare
- Këmbime nëpërmjet transfertës
- Pagesat utilitare

P.s: Per te kryer nje transfertë bankare, është e nevojshme qe ju te keni përzgjedhur shërbimin e plote te Ebanking i cili ju mundëson pajisjen e nevojshme te sigurisë (token).

Si mund të shikoj gjëndjen time të llogarisë?

Nëse ju jeni pajisur me produktin tonë e-banking, ju mund të shikoni gjëndjen tuaj të llogarisë 24 orë / 7 ditë të javës.

Si mund ti transferoj para një miku që është klient gjithashtu në Procredit Bank nëpërmjet e-banking?

Per te kryer transfertë, është e nevojshme qe ju të keni numrin e llogarisë së mikut tuaj. Përmes opsionit Transfertë, pastaj ju mund ti kaloni pagesën tek numri i llogarisë se tij. Per detaje teknike, ju lutem referohuni tek Manuali i shërbimit Ebanking, i cili është i afishuar tek faqja e Ebanking.

Si te përzgjedh kodin SWIFT, kur dua te kryej një dërgesë ndërkombëtare?

Kodi SWIFT i bankave është një kod 11 shifror. Ai mundëson, qe te zgjidhni bankën drejt te cilës po dërgoni para.

P.sh. FEFAALTRDUR i përket kodit qe identifikon Procredit Bank Durrës. 3 shifrat e fundit te këtij kodit përcaktojnë degën e bankës, ku po kryhet pagesa.



Ne rast se informacioni qe ju keni është një kod 8 shifror, ose detajet e kodit ne 3 shifrat e fundit janë te paqarta mund te zëvendësoni **këtë kod me karakteret XXX**. Ky ndryshim identifikon Drejtorinë Qendrore te Bankës ne vendin e përfituesit.

Ne rastin me sipër kodi mund te përdoret FEFAALTRXXX – Procredit Bank Drejtoria Qendrore.

Pagesat tuaja përcillen ne mënyre te sigurte dhe te shpejte nëse identifikoni qarte bankën pritëse dhe kodin e saj SWIFT, si dhe IBAN te përfituesit (për te gjithë përfituesit ne EU).

Si mund te bej nje kembim ne e-banking?

Ju duhet te keni dy llogari ne valuta te ndryshme ne Procredit Bank dhe te jeni i pajisur me produktin e-banking me token. Me pas përmes opsionit Transfertë, ju mund te kryeni kalimin e shumes, e cila automatikisht kthehet ne këmbim valutor. Per detaje teknike, ju lutem referohuni tek Manuali i shërbimit Ebanking, i cili është i afishuar tek faqja e Ebanking.

Jam klient i bankës suaj, si mund ti paguaj dritat ose ujesjellesin?

Duke u pajisur me produktin tonë e-banking ju mund ti bëni këto pagesa nga nje kompjuter nga shtëpia juaj ose kudo qe ndodheni. Per te kryer këto pagesa, ju lutem referojuni udhëzimeve tona specifike tek faqja e Ebanking.